

## Pyetje që bëhen zakonisht

### **1. Çfarë do të thotë saktësisht roaming?**

Roaming është një shërbim i ofruar nga operatorët celularë, që ju lejon të përdorni telefonin tuaj teksa udhëtoni jashtë vendit për të folur, për të dërguar mesazhe dhe për të përdorur internetin.

### **2. A është e vërtetë se, që prej 1 Korrikut 2021, nuk do të ketë tarifa roaming kur të udhëtoj në rajonin e Ballkanit Perëndimor?**

Po është e vërtetë. Duke filluar nga 1 Korrik 2021, ju nuk do të paguani tarifa shtesë për thirrjet, SMS dhe internetin që do të përdorni gjatë udhëtimit në rajon, në krahasim me atë që paguani kur jeni në shtëpi, në vendin tuaj. Ky model quhet fol si n'shpi, sipas të cilit minutat, SMS dhe GB-të që ju do të konsumoni jashtë vendit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, do të tarifohen ose zbriten nga shpenzimet e planit tuaj tarifor sikur të ishit në shtëpi. Në lidhje me përdorimin e internetit, operatorët celularë mund të zbatojnë një të ashtuquajtur limit të të dhënave të përdorimit të drejtë gjatë roamingut, në përputhje me politikën e përdorimit të drejtë. Ndaj ju lutemi që të kontrolloni e të informoheni, për detajet e mëtejshme, me operatorin tuaj telefonik.

### **3. Ku saktësisht mund të udhëtoj dhe të flas si në shtëpi?**

Ju mund të flisni si në shtëpi në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor (d.m.th. Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë\*, Mal i Zi, Maqedoni Veriore dhe Serbi), nëse jeni i abonuar me një prej operatorëve celularë të Ballkanit Perëndimor.

### **4. A zbatohet parimi “Fol si n'shpi” nëse unë telefonoj çdo vend të rajonit kur jam në roaming, apo vetëm nëse telefonoj vendin tim?**

Po, parimi “fol si n'shpi” do të zbatohet në çdo rast, pavarësisht nëse jeni duke telefonuar në vendin tuaj apo ndonjë operator tjetër celular të Ballkanit Perëndimor.

### **5. A vlen “Fol si n'shpi” për telefonata, SMS ose internet?**

Nuk do të ketë tarifa shtesë roaming për të gjitha shërbimet e roamingut: thirrjet, SMS dhe internet sa herë që jeni duke përdorur shërbime roaming në Ballkanin Perëndimor.

Në lidhje me përdorimin e internetit, operatorët celularë mund të zbatojnë një të ashtuquajtur limit të të dhënave të përdorimit të drejtë gjatë roamingut, në përputhje me politikën e përdorimit të drejtë. Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni operatorin tuaj celular.

### **6. Fol si n'shpi” zbatohet vetëm kur unë bëj telefonatë, apo edhe kur marr një telefonatë, ndërsa jam në roaming?**

Nuk do të ketë tarifa shtesë roaming për asnjërin: as për thirrjet e dalëse e as për ato hyrëse.

**7. “Fol si n’shpi” vlen vetëm për parapaguesit apo edhe për abonentet që paguajnë më pas?**

Po, vlen për të gjithë llojet e abonentëve.

**8. “Fol si n’shpi”, a është automatik apo duhet ta aktivizoj?**

Ju nuk keni pse të bëni asgjë, është automatike, pasi operatorët celularë në rajon do të aplikojnë automatikisht modelin “Fol si n’shpi”.

**9. A mbulon “Fol si n’shpi” thirrjet që bëj nga vendi im në pjesë të tjera të rajonit?**

Jo, thirrje të tilla nuk janë thirrje roaming. Kur telefononi ndërsa jeni në vendin tuaj nuk jeni në roaming dhe “Fol si n’shpi” nuk zbatohet.

**10. Nëse udhëtoj në rajon dhe telefonoj dikë, a duhet të shqetësohem nëse s’po e telefonoj në celular por në numër fiks?**

“Fol si n’shpi” zbatohet për të gjitha telefonatat roaming në rajonin e Ballkanit Perëndimor, në përputhje me planin tuaj tarifor.

**11. A zbatohet “Fol si n’shpi” kur përdor WiFi ndërsa udhëtoj në rajon?**

Kur përdorni WiFi, nuk po përdorni shërbime roaming, prandaj “Fol si n’shpi” nuk zbatohet.

**12. A ka ndonjë kufizim të sasisë për thirrjet, SMS- të dhe internetin, ndërsa unë lëviz në rajon?**

Nuk ka kufizime në lidhje me përdorimin e telefonatave dhe SMS kur jeni në roaming. Në lidhje me përdorimin e internetit, operatorët celularë mund të zbatojnë një të ashtuquajtur limit të të dhënave të përdorimit të drejtë gjatë roamingut, në përputhje me politikën e përdorimit të drejtë. Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni operatorin tuaj celular.

**13. Çfarë ndodh nëse i shpenzoj gjatë përdorimit të roamingut të gjitha minutat, mesazhet apo edhe internetin që kam si një klient i parapaguar / paguar me pas?**

Në rast se i shpenzoni të gjitha njësitet që keni, pavarësisht nëse jeni të parapaguar ose të abonuar për çdo thirrje shtesë, SMS apo internet do të tarifoheni sipas tarifave kombëtare.

**14. A mund të marr telefonata ndërsa jam në roaming nëse jam një klient me parapagim dhe kam shpenzuar gjithçka që kam në llogarinë time?**

Po, vlejnjë të njëjtat rregulla si në shtëpi, prandaj mund të merrni telefonata. Thirrjet hyrëse janë falas, njësoj si të jesh në shtëpi.

**15. A ka ndonjë afat kohor për përdorimin e telefonit tim celular jashtë vendit dhe për të folur si në shtëpi?**

Nëse kaloni më shumë kohë në shtëpi (jeni më shumë në rrjetin tuaj të brendshëm) sesa jashtë vendit, ose e përdorni celularin tuaj më shumë në vendin tuaj sesa jashtë vendit, mund të flisni si në shtëpi në rajon. Sidoqoftë, nëse operatori juaj celular vendos që në 4 muajt e fundit të keni kaluar pjesën më të madhe të kohës tuaj jashtë vendit dhe të keni konsumuar më shumë njësi

jashtë vendit, do të merrni një SMS dhe do t'ju kërkohet të përshtatni konsumin e trafikut me politikën e përdorimit të drejtë. Nëse nuk ndodh në 2 javët e ardhshme, do të tarifoheni shtesë për trafikun, d.m.th:

- 3.2 cent euro për minutë të telefonatave të bëra.
- 1.6 euro cent për minutë të telefonatave të marra.
- 1 euro për SMS.
- 0,77 euro cent për MB e cila do të ulet çdo vit deri në 1 janar 2026. Për më shumë informacion, ju lutemi lidhuni me operatorin tuaj celular.

***16. A është akoma një ide e mirë që të marrësh një kartë SIM të përkohshme lokale, kur udhëton në rajon?***

Nëse udhëtoni në mënyrë periodike dhe qëndroni për një periudhë të shkurtër kohe në një pjesë tjetër të Ballkanit Perëndimor, përgjigjja është jo. Por, nëse planifikoni të jeni në një pjesë tjetër të Ballkanit Perëndimor për një periudhë më të gjatë, duhet të kontrolloni politikën e përdorimit të drejtë të aplikuar nga operatori juaj celular për të vendosur se çfarë është më e mira në rastin tuaj.

***17. Po sikur të udhëtoj në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe të tarifohem ekstra?***

Në këtë rast duhet të kontaktoni menjëherë operatorin tuaj celular.

***18. A janë ulur edhe tarifat e roamingut me BE?***

Jo, por diskutimet mbi uljen e tarifave të roamingut midis Ballkanit Perëndimor dhe BE janë në proces.

Për më shumë informacion, shikoni faqet zyrtare të Autoriteteve Kombëtare Rregullatore, në vendet e Ballkanit Perëndimor:

Shqipëria: <https://www.akep.al/>

Bosnja & Herzegovina: <https://www.rak.ba/bs-Latn-BA/>

Kosova\*: <http://www.arkep-rks.org/>

Mali i Zi: <https://ekip.me/>

Macedonia e Veriut: <https://aek.mk/>

Serbia: <https://www.ratel.rs/cyr/>

\*Ky përcaktim nuk çënon qëndrimet mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën UNSCR 1244 dhe Opinionin e ICJ mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.